

RELACION

MIREMBAJTJE E QENDRAVE PARESORE SHENDETESORE 2024

Rikonstruksioni i kësaj qendre vjen si rezultat i pasjes së një qendre shëndetësore me funksionim normal dhe me standarte të përcaktuara.

Gjendja ekzistuese ofron kushte shumë të vështira pune dhe jashtë standarteve teknike, gjë që vë në rrezik si punonjësit ashtu edhe pacientët të cilëve i ofrohet shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor.

Qëllimi i këtij rikonstriksioni është krijimi i një qendre shendetësore , ku të siguroje të gjitha kushtet e nevojshme të shërbimit parësor shëndetësor, rikonstruksionin e plotë dhe rivitalizimin e godinës ekzistuese, si edhe krijimin e një ambjenti të brendshëm dhe të jashtëm si funksional ashtu edhe estetik, me vlera bashkëkohore dhe fuksionale.

Projektuesi ka bërë zgjidhjen arkitektonike më të përshtatshme për rikonstruksionin e godinës duke patur parasysh natyrën e veprimtarisë së Institucionit, skemën funksionale të saj, si dhe duke harmonizuar me godinat e tjera të cilat ofrojnë shërbime të ngjashme.

Sistemimeve të jashtme të objektit i është kushtuar një rëndësi e veçantë, gjithmonë duke patur parasysh nëse territori përreth godinës është në pronësi të vetë qendrës shëndetësore. Ato janë projektuar në përputhje me të gjitha normat e sigurisë dhe standardet e projektimit. Ambientet e jashtme janë kryesisht ambiente që shërbejnë për qëndrim, çlodhje prandaj rëndësi të veçantë i është dhënë krijimit të një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë.

Një pikë e rëndësishme në hartimin e projekt preventivit për rikonstruksionin e godinës githashtu është edhe përshtatshmëria për personat me aftësi të kufizuar të cilës i është dhënë rëndësi e vecantë, duke realizuar me elementët ndërtimor si pandusi i hyrjes nga niveli i tokës sistemuar deri në kuoten $+0.00$ me pjerrësi max. 5 deri 8 % konform VKM nr.1503 datë 19.11.2008 mbi "Shfrytëzimin e hapsirave nga personat me aftësi të kufizuar", si dhe janë parashikuar të gjithë elementët e tjerë ndërtimor të sinjalitika horizontale dhe vertikale me qëllim që godina e rikonstruktuar të jetë e aksesueshme për personat me aftësi të vecanta.

Përshkrim mbi punimet kryesore të rikonstruksionit që do të kryhen:

A-Punimet për infrastrukturën ndërtimore.

1. Është parashikuar prishja e të gjithë suvatimeve të brëndshme të cilat janë të amortizuara. Suvatimet e reja do të ribëhen konform K.T.Z. për këtë proces si dhe bazuar në detyrën e projektimit për rikonstruksionin e këtij objekti.
 2. Do të hiqet çatia dhe do të behet rikonstruksion i plote i çatise.
 3. Shtresat e pllakave ekzistuese janë të amortizuara, dhe të disa llojeve për shkak të ndërhyrjeve pjesore që janë kryer në objekt. Gjithashtu shtresat ekzistuese do të hiqen edhe për faktin se do të vendosen (shtrihen) nën to linjat e reja për instalimet elektrike, H/Izolimit të njeve higjeno-sanitare etj. Në punimet e shtresave bëjnë pjesë dhe veshja e re e shkallëve me mermer graniti të cilësisë I dhe montimi i korimanove prej inoksi në shkallë dhe sheshpushimet. Për rrjedhojë të gjitha shtresat e dyshemeve do të bëhen të reja, duke i shtruar me pllaka cilësore të ngjitura me kollë. Ambientet sanitare do të shtrohen me pllaka grez porcelanato me sipërfaqe poroze. Ngjyra dhe lloji i pllakës do të përcaktohen nga projektuesi dhe investitori. Në të gjithë ambientet ku shtrohen pllaka do të ketë dhe F-v plintusa me h=10 cm si vetë pllaka.
 4. Në punimet e ribërjes së suvatimeve të reja kujdes i vecantë do të kushtohet cilësisë së suvatimit. Sipërfaqja e re e suvatuar përpara lyerjes do të pastrohet mirë me zmerilim me letër dhe do të lyhet me 1 dorë prajmer dhe 2 duar hidromat plastiko (cil.I) pa përmbajtje të elementëve bakterial si dhe do kryhet lyerja me bojë akrilike të mureve të brendshme nga dyshemeja deri në lartësinë 150 cm.
 5. Në fasadën e objektit do të prishen suvatimet ekz. që janë të amortizuara. Suvatimet do të ribëhen të reja si, dhe në zonë të vecanta, do të ketë kombinime për efekte arkitekturore dhe funksionale sic është veshja e fasadës me grafiato dhe me mermer travertine me trashësi 3 cm, kryesisht në anën ku veprojnë shirat me intesitet të lartë dhe të vazhdueshëm të cilët bëhen shkak për depërtimin e lagështirës në muret perimetral të godinës. Në fasadë sipërfaqet që do të lyhen me hidromat, do të përdoret hidromat me përmbajtje lëndë kuarci të rezistueshme ndaj agjentëve atmosferik.
 6. Të gjitha ambientet e njeve sanitare do të vishen me pllaka të reja deri në lartësinë 2 m. Në këto ambiente pas realizimit të shtresës niveluese të ilustrës me t-mesatare 2-3cm, ato do të hidroizolohen me emulsion me dy duar bitum ku lartësia e h/izol mbi kuoten e dyshemesë së mbaruar të njes sanitare, do të jetë deri rreth 50 cm. Mbi shtresën do të realizohet shtresa e e dytë e ilustrës me t=2 cm. Llustra detyrimisht të jetë llustër cemento në raport 1:2 (rërë/cimento).
 7. Në muret e katit përdhe ka shenja lagështie (kapilaritet të ujit) për rrjedhojë do të kryhen punime të cilat do të disiplinonjë prezencën e lagështisë në muret e katit përdhe.
 8. Si të tilla do të jenë punimet e sistemimeve të jashme si riasfaltimi i ri në të tre anët e godinës në zonat të vecanta ku do të kryhen punime e reja, sic është ndërtimi i sistemit të ri ujëmbledhësi për ujrë sipërfaqësor duke ndërtuar kunetë të re mbrojtëse me b/arme M-200Kg/cm² e mbuluar me zgarë metalike. Do të bëhet trotuari perimetral rreth godinës të shtruar këto me pllaka betoni me ngjyra. Në katin përdhe një ndër shkaqet e cedimit të
-

dyshehesë në zona të vecanta është dhe difektimi i tubacioneve të k.u.z. ekzistuese, prandaj dhe është menduar për rinovimin e tyre me tuba të rinj dhe puseta kontrolli.

9. Në fasadën e objektit do të prishen suvatimet ekz. që janë të amortizuara. Suvatimet do të ribëhen të reja si, dhe në zonë të vecanta, do të ketë kombinime për efekte arkitekturore dhe funksionale sic është veshja e fasadës me grafiato dhe me mermer travertine me trashësi 3 cm, kryesisht në anën ku veprojnë shirat me intesitet të lartë dhe të vazhdueshëm të cilët bëhen shkak për depërtimin e lagështirës në muret perimetral të godinës. Në fasadë sipërfaqet që do të lyhen me hidromat, do të përdoret hidromat me përmbajtje lëndë kuarci të rezistueshme ndaj agjentëve atmosferik.
10. Lidhur me furnizimin dhe montimin e dyerve dhe dritareve në objekt është parashikuar që ato të vendosen të reja. Dritaret do të jenë duro plastike me dopio xham dhe gominë nga të dy anët, me hapje me rrotullim dhe praktike në pastrim. Lidhur me ngjyrën e dritareve ajo do të realizohet e bardhë duke qëndruar uniformë me godinat tjera e këtij funksioniiden. Në proj. dhe prev. është parashikuar të vendosen dhe montohen rrjetë mizash në elementët e dritares, të projektuara si të hapëshme (kanata apo sopraluçe). Në pjesën e kontaktit të dritares me davancalin e mermerit të bëhet silikonimi për të penguar depërtimin e ujit. Dyert rekomandohen të jenë me ngjyrë të celët. Dyert e nyjeve sanitare për mbylljen e tyre të jenë me shul të inkasuar në derë (jo mecelës).
11. Realizimi i detajeve ndërtimore për Personat me aftësi të kufizuar(p.a.k.), për ndërimin e pandusit do realizohet me themel e xokol betoni C- 12/15 në rastet e kur disniveleli është më pak se 50 cm dhe me soleta të plota b/a C 20/25 me trashësi 10 cm për lartësitë deri në 4 m.

B- Punimet instalatore dhe teknologjike.

1- Punimet elektrike.

Në projekt preventivin bashkëngjitur, do të gjeni fletët e projektit të detajuara për punimet elektrike. Punimet elektrike janë parashikuar të ribëhen të reja për arsye të amorizimit të atyre ekzistuese, si dhe për garantimin e rritjes së fuqisë së re të instaluar, e cila do të shoqërohet dhe me ndërhyrje dhe rinovim të automatëve kryesor në kabinën elektrike ose në secilin kat.

Për zbatimin e punimeve të reja elektrike, materialet e perdurura duhet të jenë konform normave të projektuara (shikoprojektin) si dhe kërkesave bashkëkohore të C.E por dhe ato shqiptare të përshtatura për këto punime. Kujdes i vecantë duhet ti kushtohet realizimit të sistemit të tokëzimit. Ndriculesat në dhoma janë parashikuar të vendosen mbi kokën e pacientit në h=2.5 m dhe të komandushëm nga ky i fundit me celes 1 polar me h=1m nga dyshemeja. Ndricimi në koridore dhe në ambientet e tjera është parashikuar të realizohet me llampa ekonomike (luminishente) dhe të llojit sic përcaktohen në projekt.

2- Punimet e kondicionimit Ngrohje-Ftohje.

Për sistem ngrohje në periudhën e dimrit është përdorur ngrohja me gaz vetëm në disa ambiente duke plotësuar vetëm 20% të nevojave godinës. Nisur nga kjo situatë u projektua një sistem Ngrohje-Ftohje dhe Aspirimi me kondicioner inverter.

3- Instalimet H/sanitare dhe shkarkimeve.

Për instalimet H/sanitare është parashikuar që keto të ribëhen komplet të reja për shkak të amortizimit të tyre, por dhe mosgarantimit në vazhdimësi funksionimin normal për shkak të cilësisë së dobët që kanë pasur këto tubacione dhe pajisje të cilat në kushtet e sotme nuk plotësojnë as parametrat më minimal të standarteve shqiptare të përshtatura me normat dhe ISO-t e CE. Pajisjet H/S janë parashikuar të jenë me material porcelan. Tubat e shkarkimit do të jenë tub PPV 40x3.2mm referuar iso/dis 3633.tubat e shkarkimeve vertikale do jenë me tuba PVC me spesor 3mm.Bashkimet të bëhen me ngjitës pvc të lëngëshëm special. Kollonat vertikale do të dalin për cfryrje të gazrave në taracë.

Ndër punimet e tjera H/sanitare janë dhe tubacionet e furnizimit dhe të shpërndarjes me ujë të pishëm.Furnizimi i objektit me ujë është parashikuar të bëhet në dy mënyra , me furnizim direkt nga rrjeti dhe sitem të kombinuar rezervuar-pompë shtytëse me rezervuar xingato 5000 l c-2-3 dhe pompa shtytëse me kap.Q=120l/min dhe h=30m. Njëri nga rezervaret dhe 1 pompë do të shërbejë i pavarur dhe enkas për sistemin e mbrojtjes nga zjarri. Tubacionet do të jenë prej material polipropileni dhe ngjitje me të nxehtë në gjatësi dhe bashkuese polipropileni me fileto.Objekti do të paiset me kontator(matës) të ri.Tubat do të kenë diametra sic janë në projekt ngaD=20x4.1mm deri d=63x10.5mm. Para përfundimit të shtresave të bëhen provat me ngarkesë me presion max 1.5-2 atm se presioni normal.Furnizimi i pompave të ujit me energji të garantohet duke u lidhur dhe me burimin rezevë të energjisë gjeneratorin dizel. Për rastin e furnizimit me ujë të vendosen saracineska bronxi kontrolli dhe funksionale në raste avarie. Gjithashtu janë planifikuar të vendosen pika kontrolli me fileto ose gominë në tubacionet e shkarkimit ujrave të zeza. Tubacionet e ujit të pishëm mbi tavanet dhe në mure të sistemohen me konstruksione metalike ose të kapura me grapeta cdo 1.5m.

SHENIM:

Për sqarime dhe detajime më të hollësishme përvec se ato që përshkruajnë projektet e zbatimit dhe preventivi, si dhe specifikimet teknike përkatëse, për cdo paqartësi apo sygjerim të mos veprohet pa u konsultuar paraprakisht me investitorin dhe supervizorin. Pjesë e dokumentave për porositiesin është dhe grafiku i punimeve i hartuar nga grupi i projektimit i cili përcakton kohëzgjatjen e punimeve

Për të gjitha punimet e përshkruara më lart dhe në vazhdim sipërmarrësi do të hartojë plan organizimin e punimeve i cili duhet të shërbejë jo vetëm si masë organizative për realizimin e punimeve në afat, por edhe për aktivitetin normal të veprimtarisë së qendrës dhe përrreth tij, por njëkohësisht dhe si tregues dhe zbatues i masave për sigurimin teknik të Specialistëve+Puntorëve të zbatimit,si dhe të personelit që lëviz përreth objektit. Për të gjithë zërat e punimeve të përshkruara në preventiv dhe projekt sipërmarrësi është i detyruar të kryej punimet e zbatimit, konform një plan organizimi të punimeve në kantier si dhe ligjeve dhe udhëzimeve që përcaktojnë KUSHTET TEKNIKE TE ZBATIMIT (K.T.Z) TË PRODHIMIT DHE FURNIZIMIT ME MATERIALE të certifikuara KONFORM NORMAVE SHQIPTARE sipas STASH dhe të përshtatura me ato të CE dhe ISO-t përkatëse për punimet në objekt.

Ing.Florinda HILAJ
